

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË -KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË ,KOSOVO POLJE

Ekstrakt nga procesverbali, mbledhja e trembëdhjetë - XIII e Kuvendit të Komunës, e mbajtur me datën 28.12.2023, ora 10:00h, në Sallën e Kuvendit të Komunës.

Prezentë në mbledhje ishin anëtarët e Kuvendit të Komunës: Ali Ismaili - Kryesues i Kuvendit të Komunës, Mirlinda Krasniqi, Miranda Shabani, Jetmir Berisha, Vjollca Konjusha, Krenar Dumani, Laureat Gojnovci, Jahush Krasniqi, Fisnik Sllamniku, Etnik Berjani, Fidan Berisha, Durim Hajra, Hasime Kostanica, Shpend Bardiqi, Habib Mekolli, Vlonjat Hasani, Mirsad Qyqalla, Dardane Sogojeva Shala, Aida Alimi, Migjen Kolshi, Qëndresa Ademi, Artan Asllani, Arbnore Kelmendi, Hasan Ismajli dhe Radoman Doderovic.

Mungon: Bashkim Krasniqi - Zëvendës Kryesues i Kuvendit të Komunës për Komunitete dhe Doruntina Jashari.

Kryetari i Komunës dhe Drejtorët e Drejtorive të Komunës: Amir Bullatovci - Drejtor për Administratë, Abdullah Prebreza - Drejtor për Planifikim Urban, Ekrem Berjani - Drejtor për Zhvillim Ekonomik, Fatlum Berisha - Drejtor për Arsime dhe Ali Topalli - Drejtor për Kulturë, Rini dhe Sport.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës përshëndeti të pranishmit në mbledhje, pas verifikimit të prezencës së anëtarëve të Kuvendit të Komunës, konstatoi se ekziston kuorumi për mbajtjen e mbledhjes dhe prezantoi këtë:

REND DITE

1. Betimi i anëtarit të ri të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës.
2. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e datës 30.11.2023.
3. Pyetje dhe përgjigje parlamentare.
4. Shqyrtimi i parë i Projekt-Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024.
5. Shqyrtimi i dytë i Planit Lokal të Veprimit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje për 2024 - 2026.
6. Shqyrtimi i dytë i Projekt-Rregullores Komunale për Transparencë në Komunën e Fushë-Kosovës.
7. Shqyrtimi i Marrëveshjes për Bashkëpunim me Komunitetet e Regjionit të Prishtinës.
8. Shqyrtimi i kërkesës për ndërrimin e anëtarit të Komitetit për Politikë dhe Financa.
9. Shqyrtimi i kërkesës për ndërrimin e anëtarit të Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
10. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës lexoi pikat e rendit të ditës dhe hapi diskutimin.

Hasan Ismajli: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë e kam një kërkesë për kolegët e mi që ta bëjnë një deklaratë të tyre lidhur me procedurën e themelimit dhe përfaqësimit të entiteve politike në Komitetet e Përhershme, sepse sipas Statutit të Komunës së Fushë-Kosovës të vitit 2012, në komunën tonë Komiteti për Politikë dhe Financa në kundërshtim me dispozitat e statutit të komunës i ka shtatë anëtarë, ndërsa duhet t'i ketë nëntë anëtarë, kurse sipas dispozitave të udhëzimit administrativ të vitit 2019, në komunat ku janë tridhjetë e pesë mijë deri në katërdhjetë mijë banorë, duhet të ketë vetëm shtatë anëtarë, te ne Komiteti për Komunitete i ka nëntë anëtarë, ku janë edhe katër përfaqësues të partive politike shqiptare, pa të drejtë aty, unë deklaram e kërkoj nga kolegët e mi kur të vijmë të shqyrtimi i pikës së tetë të rendit të ditës.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim rendin e ditës.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e pesë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave e aprovoi rendin e ditës për shqyrtim në mbledhjen e sotme.

Pika e parë (1) - Betimi i anëtarit të ri të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani e kemi procedurën e betimit të anëtarit të ri të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës dhe për këtë çështje duhet të formojmë një Komision prej tre anëtarëve për verifikimin e mandatit të anëtarit të ri të Kuvendit të Komunës, andaj ju ftoj t'i jepni propozimet e juaja.

Pas diskutimeve nga subjektet politike u dhanë propozimet që anëtarë të Komisionit të jenë: Fisnik Sllamniku, Hasime Kostanica dhe Migjen Kolshi, ky komision u formua me unanimitet të votave.

Fisnik Sllamniku: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Pas punës tonë si Komision i Kuvendit të Komunës për verifikimin e mandatit të anëtarit të ri të Kuvendit të Komunës, sipas vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe listës zgjedhore, janë plotësuar të gjitha kushtet që anëtari i ri i Kuvendit të Komunës z. Fidan Berisha ta bënë Deklaratën e Betimit.

Fidan Berisha: Përshëndes të pranishmit në mbledhje.

Para anëtarëve të Kuvendit të Komunës të pranishëm në sallën e Kuvendit të Komunës e lexoi dhe nënshkruajti 'Deklaratën e Betimit' për anëtarë të Kuvendit të Komunës që parashihet sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Anëtarit të ri të Kuvendit të Komunës i dëshiroi punë të mbarë dhe suksese.

Pika e dytë (2) - Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e datës 30.11.2023.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim dhe aprovim ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e mbajtura me datën 30.11.2023, hap diskutimin për vërejtjet dhe sugjerimet e juaja.

Durim Hajra: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Ne nuk do të votojmë për ekstraktet e procesverbaleve, për deri sa nuk respektohen dispozitat e 'Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës', po ashtu ju bëjmë thirrje edhe një herë që të rregulloni çështjen e transparencës.

Mirsad Qyqalla: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Ne nuk do të votojmë për ekstraktet e procesverbaleve, për deri sa nuk respektohen dispozitat e ‘Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës’.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e mbajtur me datën 30.11.2023.

U votua me: pesëmbëdhjetë vota ‘për’, nëntë vota ‘kundër’ dhe një abstenim, gjithsej njëzet e pesë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave të anëtarëve të pranishëm të Kuvendit të Komunës në mbledhje e aprovoi ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e mbajtura me datën 30.11.2023.

Pika e tretë (3) - Pyetje dhe përgjigje parlamentare.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi pikën ‘Pyetje dhe përgjigje parlamentare’, ftoi anëtarët e Kuvendit të Komunës, që të parashtrojnë ndonjë pyetje, nëse kanë për Ekzekutivin e Komunës.

Hasan Ismajli: Faleminderit Kryesues, tani në muajin dhjetor Drejtoria e Arsimit ka filluar renovimin e Gjimnazit ‘Hivzi Sulejmani’ në Fushë-Kosovë, renovimi është duke u bërë vetëm në katin e parë, aty ka nevojë që të rregullohet tauleti për persona me nevoja të veçanta, sepse është një nxënës në karrocë, aatë e ndihmojnë nxënësit, por unë mendoj se ka mënyra tjera ligjore për zgjidhjen e kësaj çështje. Pyetja tjetër ka të bëjë me lëndimin e punëtorëve në punë, këtu duhet të jetë më e përgjegjshme Drejtoria e Inspektoratit. Në mbledhjet e Kuvendit të Komunës nuk vjen Drejtori i Drejtorisë së Gjeodezisë Kadastrit dhe pronës, sepse ne jemi duke i kërkuar pronat e komunës dhe ai nuk na i ka dhënë deri sot. Një pyetje tjetër e kam për Drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike e Mjedisit i cili nuk është këtu apo kësaj pyetje mund t’i përgjigjet Drejtori i Drejtorisë së Administratës, ose juve i nderuari Drejtor i Drejtorisë së Infrastrukturës, për vizitën e fundit të delegacionit të komunës tonë në Turqi, sepse unë e kam kuptuar se udhëheqës i rrugës dhe përfaqësues i komunës tonë atje, ka qenë Drejtori i Administratës, ndërsa edhe ju keni qenë pjesëmarrës në atë udhëtim zyrtar. Pyetja kryesore lidhur me udhëtimet zyrtare dhe pagesa e mëditjeve me pasaportë të Serbisë, ka të bëjë me udhëtimin e Zëvendës Kryesuesit të Kuvendit të Komunës për Komunitete në Komunën e Fushë-Kosovës, ai merrë mëditje duke e paraqitur pasaportën e Republikës së Serbisë, me vendbanim në Novi Sad, ju këtë punë e lejoni sepse personin në fjalë e keni partner të kualicionit qeverisës, ju këtu e keni bërë pagesën e biletës së udhëtimit në një rastë tjetër, po ashtu edhe pagesën e mëditjeve në dy raste për këtë person zyrtar dhe në fund nga ju i nderuari Kryesues i Kuvendit të Komunës, kërkoj sqarime lidhur me pagesat shtesë të asistentes tuaj, ne kërkojmë të dijmë cilat punë shtesë janë kryerë për Kuvendin e Komunës.

Mirsad Qyqalla: Përshëndetje për të gjithë, kam disa pyetje për Ekzekutivin e Komunës. Po filloj me Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit për vendosjen e shtyllave që i kanë vendos në trotuare dhe është shumë e paqartë, se a’na mohohet parkingu neve banorëve të banesave, te cilat kur i kemi blerë pronarët e tyre, na kanë thënë se janë parkingje publike të përbashkëta dhe tani Komuna e Fushë-Kosovës i ka vendosur shtyllat, nëse kjo punë ka qenë për lirimin e parkingjeve është gjithçka në rregull, edhe pse po na e vështirëson këtë pjesë. Unë dua të parashtroj një pyetje pse në rrugën ‘Xhemajl Mustafa’ tek ‘Marketi Albi’ në Fushë-Kosovë, vetëm atij nuk u janë vendosur këto shtylla dhe shihet qartë se këtu ka njerëz të privilegjuar, edhe pse është vendim i

komunës për vendosjen e këtyre shtyllave për lirim të parkingjeve dhe unë dua të di arsyen pse. Pyetjen tjetër e kam për Drejtorin e Drejtorisë së Arsimit, ne e dimë që një shkollë është në renovim, në asnjë rrethanë nuk pajtohemi me kohën kur ka filluar ky renovim. Këtu janë pesë ditë të humbura dhe nuk e di, se kush do ta mbajë përgjegjësinë për këto pesë ditë të humbura të mësimit, sepse ato duhet të zëvendësohen. Ndriçimi publik asnjë muaj nuk ka funksionuar siç duhet edhe pse ndahen mjetet financiare, planifikohet me buxhet, tani Drejtori ka filluar të mos marrë pjesë në mbledhjet e Kuvendit të Komunës. Një lajm shqetësues për mua dhe për këtë arsye mendoj që është dashur të marrë pjesë edhe Ekzekutivi i Komunës, sepse edhe pyetjet kur po i parashtrijmë po na thuhet, që të ju drejtohem me shkrim. Vetëm ditët e fundit unë i kam parë pesë vendime që u'a ka dhënë Agjencia për Privatësi dhe Informim, ku vlera totale e tyre ishte afër 17,000.00€, për mos qasjen në dokumente zyrtare, kjo më shqetëson sepse nuk e kemi luksin që ta gjuajmë paranë publike. Çfarë probleme kanë ato dokumente të cilat nuk bënë të publikohen dhe fakti që nuk na jepen dokumentet, a ka diçka mbrapa tyre pasi që edhe më herët ka pasur dënime për mos qasjen në dokumente publike dhe vlera shkon afër 30.000.00€. Kam një pyetje tjetër për Rrugën 'Udhë e Shehrit' në fshatin Bardh i Madh, aty në udhëkryq të rrugës janë mbjellur fidanë dhe një fidan i vendosur aty në mes të rrugës, shërben si shenjë identifikuese në komunikacion, ne kërkojmë që ky fidan të largohet nga rruga. Në fshatin Sllatinë të Vogël, është një person me mbiemrin Dragusha, i cili thotë se kam qenë tek Kryetari, tek Drejtori i Urbanizmit, ai thotë se komplet shaktat e kanalizimeve i kanë mbyllur me asfalt dhe e kanë dëmtuar ujësjellësin, prandaj kam ardhur dhe kam ngritur shqetësimin tim, kam kërkuar llogari mirëpo nuk kam marrë përgjigje. Të nderuar duhet të dilni dhe të verifikoni sepse ky qytetarë po mendon, se keni diçka personale me të. Po të drejtohem ty Kryesues, rregulloret kur i kemi punuar, ne kemi qenë të gjithë të pakënaqur, mirëpo kemi punuar pjesërisht në Grupe Punuese dhe jemi shpejtuar, që t'a zëm këtë vitë, mirëpo nuk e di çfarë është duke ndodhur, sepse vetëm një rregullore ka ardhur në shqyrtimin e dytë. Po i drejtohem Drejtorit të Drejtorisë së Arsimit, për rastin e çerdhes që ka ndodhur pasi na keni fajësuar për kohën e shpejtë, që kemi kërkuar mbledhje të jashtëzakonshme dhe na u është thënë se duhet kohë dhe Nënkryetari i Komunës, ka thënë se e kemi formuar një Komision. Pyetja ime është Vendimet që i keni marrë, arsyet pse ka ndodhë dhe të gjitha faktet që Komisioni i ka verifikuar sa i përket rastit. Sot në fshatin Bardh i Madh, do të bëhet përrurimi i ndërtimit të rrjetit të ujësjellësit për furnizim me ujë nga Qeveria e Kosovës, e udhëhequr nga Lëvizja Vetëvendosje, ata do ta përdorin këtë çështje, por jeni ju ata, që ua keni dhënë këtë mundësi, meqë nuk keni investuar në të kaluarën.

Durim Hajra: Faleminderit Kryesues, përshëndetje për te gjithë të pranishmit në mbledhje. Po filloj si çdo herë me Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit. Pyetja e parë ka të bëjë me një kontratë kornizë me Nr. 612-23-6885-1-2-1 që ka të bëjë me 'Furnizimin dhe shtruarjen e rrugëve me zhavor', ku vlera e kësaj kontrate kornizë me sa e pash në e-prokurim është 78.790,00€, ku tek kjo kontratë pamë se deri më tani janë paguar për situacionin e parë shuma e mjeteve financiare prej: 40.296,00€, ndërsa në teren shohim se mungon zhavori, pyetja legjitime e jona tani është, ku është shtruar ky zhavor, nëse është bërë pagesa, sepse është shkelje ligjore për të bërë parapagim me paranë publike, nëse nuk është parapagim, atëherë duhet me qenë një raport i bashkangjitur tek dosja e kësaj lënde. Pres një përgjigje të shpejtë për ndryshe do fillojmë procedurave tjera, sepse fatkeqësisht Komuna e Fushë-Kosovës ka shumë kontrata të tilla. Ndriçimi publikë nuk

funksionon, tani unë nuk do të përmendi me emra rrugët e caktuara, sepse aty janë përmendur disa herë këtu, edhe këtu gjatë vitit 2022 dhe 2023 neve na është thënë se kemi të bëjmë me një kontraktorë të papërgjegjshëm, por kontrata i është dhënë kontraktorit të njëjtë. Po ashtu tani jemi në dimër dhe nuk e kemi një kontratë për mirëmbajtjen e rrugëve dhe trotuareve. Kërkesë e qytetarëve është që të shikolla Aneksi 1, të mos lejohet parkimi i automjeteve në rrugën kryesore në kohën e pikut, sepse andej kalojnë nxënësit, aty duhet të gjindet një model për kalimin e lirë të nxënësve. Rruga për në Kalanë e fshatit Harilaç, atje tani është hapur një restaurant, aty janë vendosur pengesa për kufizimin e shpejtësisë. Për Drejtorin e Drejtorisë së Gjeodezisë Kadastrit dhe Pronës janë disa ngastra kadastrale që gjinden në lagjen e Dardanisë, ku ngastra publike me Nr. 428-3, në lagjen e Dardanisë më herët ka qenë pronë publike, tani ajo është private, kjo punë është bërë pa vendim të Kuvendit të Komunës, është ndërruar pronari i saj, është ndërruar fleta poseduese, madje kjo punë ka ndodhur në këto gjashtë vite sa unë jam anëtarë i Kuvendit të Komunës dhe ne nuk e kemi marrë asnjë vendim. Për lokalet te Stadiumi i Qytetit ne kemi thënë në të kaluarën, se ka shumë zhurmë, ajo zhurmë është larguar pas intervenimit, kjo punë ka zgjatur vetëm një muaj, pastaj është rikthyerë prapë. Këtu në mbledhje, nuk është as Kryetari, as Nënkryetari i Komunës, për ta marrë një përgjigje për zbatimin e dertanishëm të premtimeve elektorale, tani kur jemi në gjysmën e mandatit zgjedhor, ne nuk e kemi asnjë raport të auditimit të brendshëm, ku janë dy zyrtar, ku njëri prej tyre është sanksionuar me masë disiplinore, përkundër faktit se ai është i mbrojtur për lajmërimin e të gjeturave, edhe me Ligjin për mbrojtjen e sinjalizuesve, madje faktin për mos funksionimin e auditimit të brendshëm e thekson në raportin e tij edhe auditimi i jashtëm. Pyetja ime tjetër ka të bëjë me informimin tonë, kush është zyrtari për pasuri i komunës, a ka ndonjë raport të tij, për regjistrin e pronave, të cilin ne e kërkojmë që të na dorëzohet me shkrim, nëpërmjet raporteve të punës.

Aida Alimi: Përsëritës të pranishmit në mbledhje. Unë kolegut tonë të ri në Kuvendin e Komunës z. Fidan Berisha i dëshiroi punë të mbarë dhe suksese. Lidhur me sigurinë transparenca është zero, andaj unë kërkoj në vazhdimësi që ne ta kemi një raport të punës nga Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, sepse ne jemi pa përgjigje për zhvillimin e dukurive negative nga Drejtoria e Inspektoratit. Nga Drejtoria e Arsimit kam kërkuar që të bëhet vendosja e rafteve për libra në shkollat tona, në mënyrë që të mos dëmtohen nxënësit tonë nga bartja e peshës së rëndë të librave, disa do t'i vendosnin në raftet e shkollës. Në kuadër të shëndetësisë kam kërkuar ndarjen e mjeteve financiare për blerjen e Mamografit, por nuk ka ndonjë veprim konkret deri tani. Këtu në sallën e Kuvendit të Komunës mikrofonat nuk funksionojnë. Ne këtu kërkojmë që të marrim përgjigje në pyetjet tona nga Drejtorët e Drejtorateve të Komunës, të dijmë rrjedhën e realizimit të projekteve publike. Lidhur me organizimet e datës 8 mars, pra Ditës së Gruas, unë kam bërë organizimin e saj vitin e kaluar së bashku, meqë jam edhe Kryesuese e Grupit të Grave, por unë nuk dua ta lejoj si punë normale hedhjen e akuzave ndaj meje, andaj dua ta bëjë një reagim të qartë këtu, unë kam kërkuar që prezentë në udhëtime zyrtare të Zyrës për Barazi Gjinore, të jetë së paku dikush nga asambleistët e Kuvendit të Komunës. Përkrahja dhe gatishmëria ime për këtë Zyrë dhe kërkesat e saj në Kuvendin e Komunës, nuk ka munguar asnjëherë, por tani këtu nuk dua ta ulë nivelin e debatit më shumë, sepse të gjithë i dijmë deklaratimet dhe akuzat e thëna në mbledhjen e kaluar të Kuvendit të Komunës nga Zyrtarja për Barazi Gjinore.

Shpend Bardiqi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë dua ta dijë, a punon dikush tjetër nga Ekzekutivi i Komunës, sepse Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, e dijmë të gjithë që ka pengesa ligjore në punën e tij, drejtori ka hyrë në burg, dakort arrest shtëpiak, dikush duhet të përgjigjet për punën e kësaj Drejtorie Komunale.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Unë kërkoi nga të gjithë ju që ta keni një qasje serioze në foltoren e Kuvendit të Komunës, e bëjë këtë në formë të lutjes, në mënyrë që të mos ju ndërpresë në fjalimin e juaj.

Shpend Bardiqi: A është në arrest shtëpiak drejtori, këtu duhet të jetë Nënkryetari i Komunës, kjo punë ka ndodhur pas të gjeturave të raportit të auditimit të jashtëm, pastaj në bazë të kësaj të gjeture faktike e juridike, është arrestuar drejtori nga Prokuroria e Shtetit dhe ne duhet ta kemi një sqarim zyrtar, lidhur me këtë gabim apo shkelje, që ka ndodhur nga ana e juaj, sepse ju raportin e auditimit e keni pranuar, nuk keni bërë ndonjë kundërshtim me fakte. Këtu te ne Drejtori i Drejtorisë së Administratës është inekzistentë, këtu dritat janë sikur në filmat horror, jashtë komunës për disa muaj ndërtohen pesëmbëdhjetë katë, ndërsa në ndërtesën e komunës për një vitë nuk ka përfunduar asnjë katë, sikur të ishte duke u ndërtuar Kulla e Aifellit në Komunën e Fushë-Kosovës. Është lëshuar një komunikatë lidhur me të ashtuquajturën Shtëpinë e Kulturës në fshatin Sllatinë e Madhe, meqë ju këtë term e keni shpikur, është marre për neve, me rastin e djegjes së saj. E keni akuzuar qeverisjen qendrore për ndarjen e vitrave, por edhe ju po ndani vitra madje vetëm nga pesëdhjetë euro, por nuk pritet më mirë nga një komunë, ku mirren mëditje edhe me pasaportë të Serbisë, që u cekë këtu nga anëtar i Kuvendit të Komunës z. Hasan Ismajli.

Hasan Ismajli: Këtu mëditjet janë marrë me pasaportë të Republikës së Serbisë, me vendbanim në Novi Sad, ndërsa udhëtimi zyrtar është realizuar në emër të Komunës së Fushë-Kosovës, në cilësinë e zëvendës Kryesuesit të Kuvendit të Komunës për Komunitete.

Dardane Sogojeva Shala: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Anëtarit të ri të Kuvendit të Komunës z. Fidan Berisha i urojmë punë të mbarë dhe suksese në pjesën e mbetur të mandatit zgjedhor. Pse askush nga komuna nuk ka marrë pjesë në varrimin e polices së ndjerë znj. Miradije Berisha, ku ka patur edhe përfaqësues nga Komuna e Vushtrrisë. Tani e kam një pyetje për Nënkryetarin e Komunës dhe Drejtorin e Drejtorisë së Arsimit lidhur me konkurrimin e aplikantëve për fitimin e bursave për studentë, ku bursa të tilla fitojnë edhe studentët që i kryejnë studimet në Universitetin e Mitrovicës së Veriut, që udhëhiqet nga z. Goran Rakiq, këto lëndë janë për shqyrtim dhe hetim nga Prokuroria e Shtetit. Banorët e fshatit Sllatinë e Vogël kërkojnë që rruga e asfaltuar nga Viva-Freshi deri tek rruga për parkun e pishave, të rregullohet sepse është pa trotuar, po ashtu kërkojmë që të mirren me rregull mbeturinat nga Kompania 'Pastrimi'.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani kanë kaluar një orë e pesëmbëdhjetë minuta, ne ende jemi në fazën e parashtrimit të pyetjeve parlamentare, andaj sqaroi se përgjigjet lidhur me këto pyetje mund të mirren në mbledhjen e ardhshme.

Laureat Gojnovci: Sikur edhe ju të gjithë, edhe unë si anëtar i Kuvendit të Komunës, kam qenë i njoftuar me qëndrimin e parardhësitë tim z. Remzi Shala, për dakordimin e juaj për Planin Vjetor të Punës, që koha e parashtrimit të pyetjeve të jetë dyzet minuta, ndërsa koha për përgjigjet e Ekzekutivit të Komunës njëzet minuta, kjo rregull nuk po respektohet në mbledhjet e Kuvendit të Komunës, andaj nëse dakordohemi ne jemi që përgjigjet të jepen në mbledhjen e ardhshme.

Durim Hajra: Ju këtu jeni shumë gabim, këtu anëtarët e Kuvendit të Komunës po paraqesin për shqyrtim dhe marrje të përgjigjeve, çështje reale që i preokupojnë qytetarët e komunës, tendenca për të ulur nivelin e punës së Kuvendit të Komunës për ne nuk është e pranueshme.

Mirsad Qyqalla: Me kufizimet kohore duhet të jemi të qartë, por tendenca për të ndërprerë fjalën e lirë, pa përgjigje në pyetjet tona nuk është në rregull, këtu Ekzekutivi i Komunës dhe drejtorët e kanë obligimin e vetë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani në 70% të Kuvendeve të Komunave nuk e kanë pikën 'Pyetje dhe përgjigje parlamentare', marrjen e përgjigjeve ju mund ta kërkonit edhe me shkrim, nëse vazhdoni kështu me zgjatjen në këtë pikë, ne mund ta pezullojmë për tre muaj, sepse jeni duke e zgjatur me komente të zgjeruara, e jo me pyetje konkrete, ne të gjithë jemi prezentë këtu dhe e dijmë kush e zgjatë me komentim në parashtrimin e pyetjeve për ekzekutivin e Komunës.

Qëndresa Ademi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë e kam një shqetësim lidhur me qentë endacakë në lagjet 028 dhe 029 në Fushë-Kosovë, këtu çështja është shumë serioze, po ashtu pas reshjeve të shiut uji del në rrugë në lagjet tona. Ndërsa lidhur me atë që u cekë nga anëtari i Kuvendit të Komunës z. Hasan Ismajli, këtu raporti duhet të bëhet me kërkesën për realizimin e udhëtimit zyrtarë.

Habib Mekolli: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë e kam një pyetje për Drejtorin e Drejtorisë së Arsimit, në gjimnazin 'Hivzi Sylejmani' kishin filluar renovimet edhe pse koha është shumë e papërshtatshme, sepse fëmijët kanë humbur shumë orë mësimore, një herë për shkak të mungesës së profesorëve të cilët kanë shkuar në Shqipëri, pastaj pushimi vjeshtor, tani pesë ditë pune pushim për renovim, unë mendoj se ka pasur shumë probleme në mësimnxënie në këtë gjysmëvjetor. Kishte qenë mirë edhe rrugën afër shkollës ta bëjmë një kahëshe për shkak të mos gjatësisë së madhe të asaj rruge, sepse është shumë rrezik për nxënësit. Sa i përket ndihmave për fundvit, që Komuna e Fushë-Kosovës i ka dhënë, është se zyrtarët i kanë bërë dhurata vetes me taksat e qytetarëve, ndërsa për faljen e tatimit në pronë, nuk shprehen dëshirë të ju ndihmojnë qytetarëve të Fushë-Kosovës. Tek Rruga 'Pandeli Sotiri', e cila është rrugë përballë rrugës 'Naser Sekiraga', disa qytetarë janë ankuar se në këtë rrugë për njëzet vite nuk ka ndërhyrje, ndërsa rruga 'Naser Sekiraga', është e planifikuar për herën e tretë të asfaltohet, kurse në rrugën 'Pandeli Sotiri', nuk ka asnjë intervenim.

Migjen Kolshi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Tani unë bashkëvendësit tim z. Fidan Berisha i dëshiroi punë të mbarë dhe suksese, shpresojmë që së bashku do të arrijmë të mbrojmë interesat e banorëve të fshatit Harilaç. Ne kërkojmë nga Drejtoria e Planifikimit Urban, që rruga 'Amir Elmazi', është bërë e pakalueshme të rregullohet. Nga Drejtoria e Arsimit kërkojmë që oborri i shkollës të Aneksi 1, të lirohet për nxënë, po ashtu kërkojmë që të hapet një klasë për parashkollorë edhe në fshatin Harilaç, ku unë kam informata që konkursi publikë për fshatin tonë është anuluar me urdhër të Kryetarit të Komunës dhe kjo kërkesë e banorëve të fshatit tonë nuk është plotësuar. Për të mos ardhur në situata të tilla sikur tani, unë kam propozuar që ta kemi një pikë për 'Deklarime jashtë rendit të ditës', në mënyrë që të mos bëhen komente të zgjeruara, kur parashtrihen pyetje për Ekzekutivin e Komunës.

Vlonjat Hasani: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Kolegut të ri të Kuvendit të Komunës unë i dëshiroi punë të mbarë dhe suksese. Tani po filloj si çdo herë me shqetësimet e rrugës 'Lumi' në fshatin Miradi të Epërme, e cila ka probleme dhe po vazhdojnë të rriten çdo herë e më shumë, kur po ka reshje për shkak që nuk ka rrjetë të kanalizimit ajo rrugë, po ashtu edhe rrugët e tjera kanë

të njëjtin problem. I kam disa kërkesa të bizneseve të vogla të cilat po kërkojnë subvencionim prej komunës, sikurse po bëhet në disa lloje të tjera të bizneseve, ndërsa kontrolli i deponive të jashtëligjshme të mbetjeve inerte të cilat kanë filluar ta mbulojnë komunën tonë kryesisht fshatrat, është mirë që Drejtoria e Inspektoratit, të filloj të inspektoj më shumë këto deponi dhe të shqiptoj gjoba që ky fenomen të ndalohet. Desha ta parashtroj një pyetje edhe pse nuk po e di, se a është nën kompetencën e Drejtoreshës së Shëndetësisë, se cilat masa do t'i ndërmerrni për sanimin e këtyre dëmtimeve të cilat janë bërë në objektin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi', ku janë investuar mbi njëqind mijë euro dhe ende nuk është bërë një vit dhe kanë filluar të dëmtohen muret e brendshme, ndërsa ju keni filluar renovimin e jashtëm, me të vërtetë këtu është një katrohurë. Projekti për rrethoja në dy fshatra për fushën e futbollit dhe shkollën në fshatin 'Miradi të Epërme' dhe në fshatin 'Graboc i Poshtëm', unë e kam parë atë projekt në prokurim, ashtu siç ka dalur dhe i kam parë punët siç janë në teren dhe shikoni mirë, sepse pastaj patjetër që duhet të dërgohen në krime ekonomike, nëse përmbillet si i tillë sepse siç duket ka devijim të këtij projekti, shikojeni se kush është kompetentë për këtë projekt sepse kemi devijim të këtij projekti dhe unë personalisht, do ta dërgoj në krime ekonomike. Më herët folën edhe kolegët për dënimet e Kryetarit të Komunës, për mosdhënien e përgjigjeve tona për dokumente publike dhe brenda vitit kalendarik janë afërsisht rreth 35,000.00€ dënime të cilat kanë ardhur në emër të Kryetarit të Komunës dhe unë mendoj se është një dëm shumë i madh për Komunën e Fushë-Kosovës të ketë kaq shumë gjoba. Një pyetje të cilës nuk i jepni përgjigje ju kushton 4,000.00€. Infrastruktura siç e dimë për secilën rrugë ka nevojë për renovim, pasi që i kemi shumë të dobëta. Po ashtu për Sallat Sportive kishte qenë mirë të tregoni, se çka është duke ndodhur meqenëse Drejtori i ri nuk qenka i pranishëm këtu.

Hasime Kostanica: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Pyes Drejtoreshën e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, gjatë muajit tetor është bërë ekzaminimi me mamografi, ne kërkojmë një informatë që ta dijim se si ka rrjedhur ky proces.

Artan Asllani: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. I nderuari Kryesues i Kuvendit të Komunës, unë këtu jam përfaqësues i komunitetit ashkali, e përfaqësoi një parti politike të komunitetit tonë, por kur anëtar i Kuvendit të Komunës z. Hasan Ismajli e ngriti këtë çështje për anëtarin e Kuvendit tonë z. Bashkim Krasniqi, dua të sqaroj se legjislacioni ynë e lejon dyshtetësinë, ai ka mundur ta përdorë pasaportën e caktuar për arsye të kalimit të kufijëve. Kur u folë për këtë punë unë i mora disa shikime jokorrekte nga kolegët prezentë këtu në sallën e Kuvendit të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Këtu z. Bashkim Krasniqi e përfaqëson një komunitet, këtu ideja është pse e ka përdorë pasaportën e Republikës së Serbisë, për marrjen e mëditjeve si Zëvendës kryesues i Kuvendit të Komunës për Komunitete, konstatimi i juaj nuk është korrekt, sepse ne të gjithë këtu jemi kolegë dhe e respektojmë njëri-tjetrin.

Hasan Ismajli: Tani këtu ju i nderuari anëtar i Kuvendit të Komunës z. Artan Asllani më keni keqëkuptuar, unë e di që lejohet dyshtetësia dhe shumë persona mund ta kenë atë, këtu çështja është se pasaporta e Republikës së Serbisë, është përdorë nga një Zëvendës Kryesues i Kuvendit të Komunës për Komunitete, këtu bindja ime është që institucioni të përdoret pa devijuar, sepse edhe banorët nga Komuna e Medvegjës mund të kenë dy shtetësi, këtu problemi është se personi në fjalë është regjistruar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve në Republikën e Kosovës, unë kërkoj llogari pse është bërë pagesa e biletës së tij nga Drejtoria e Financave dhe Buxhetit, me

pasaportë të Republikës së Serbisë me vendbanim në Novi Sad, andaj ne e kërkojmë një raport zyrtarë për këtë shpenzim, mirëpo ai raport nuk na është dorëzuar.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Përgjigjet e Ekzekutivit të Komunës do t'i merrni në mbledhjen e ardhshme.

Pika e katërt (4) - Shqyrtimi i parë i Projekt-Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani e kemi në shqyrtimin e parë 'Planin e Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024', i cili është përgatitur nga Grupi Punues i formuar me vendimin e Kuvendit të Komunës, ku subjekti politikë Lëvizja Vetëvendosje nuk e ka dhënë personin për pjesëmarrje në punën e Grupit Punues. Hap diskutimin.

Laureat Gojnovci: Ne kemi qenë pjesëmarrës në punën e Grupit Punues si subjekt politikë, andaj jemi që 'Plani i Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024', të aprovohet në parim për diskutim publikë.

Mirsad Qyqalla: Ne Grupi Parlamentarë i Partisë Demokratike të Kosovës, tani e lëshojmë mbledhjen e Kuvendit të Komunës, meqë Kryesuesi i Kuvendit të Komunës në mënyrë arbitrare, po i mbron përfaqësuesit e Ekzekutivit të Komunës.

Durim Hajra: Edhe ne si Grup Parlamentarë i Lëvizjes Vetëvendosje, e lëshojmë mbledhjen e Kuvendit të Komunës, për arsye që u cekë edhe nga parafolësi im.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Këtu i nderuari z. Durim Hajra në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, anëtarët e Grupit tuaj parlamentarë po bëjnë komente të zgjeruara dhe këtu po humbet 80% e kohës, këtu nëntë anëtarë kanë parashtruar pyetje dhe kanë kaluar dy orë deri tani, pyetjet duhet të bëhen brenda rregullave që jemi dakorduar, edhe me juve si Shefa të Grupeve Parlamentare, unë këtu e ndërpreva këtë punë dhe ju thashë se të tjerët pyetjet mund t'i paraqesin me shkrim, po ashtu theksova se përgjigjet për pyetjet e parashtruara, do të mirren në mbledhjen e ardhshme nga Ekzekutivi i Komunës.

Laureat Gojnovci: Tani unë kolegut tonë në Kuvendin e Komunës z. Fidan Berisha i uroi punë të mbarë dhe suksese. Në emër të Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës pajtohem që 'Plani i Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024', të aprovohet në parim dhe të kalon në procedurën e diskutimit publike, meqë i parasheh të gjitha punët dhe aktivitetet që burojnë nga legjislacioni në fuqi dhe Statuti i Komunës së Fushë-Kosovës.

Fisnik Sllamniku: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Së pari këtu me planin e punës vetë ne e kemi caktuar kohën për pyetje parlamentare në kohëzgjatje prej 40 minutave, kjo kohë nuk është respektuar nga përfaqësuesit e opozitës, koha e pyetjeve secilën herë ka zgjatur përtej kohës së planifikuar për këtë punë, ne këtu jemi të thirrur që të jemi të frytëshëm në trajtimin e çështjeve, ku po përsëriten shumë fjalët e njëjta.

Hasan Ismajli: I nderuari Kryesues i Kuvendit të Komunës, unë këtu nuk dal pa e patur ndonjë faktë, pyetjet kanë nevojë për një elaborim të shkurtër dhe unë këtë e bëjë, asnjëherë nuk zgjatëm shumë në komentime të njëjta. Ne këtu jemi me pagë, jemi në vendin e punës, andaj kërkojmë që pyetjet tona, edhe kur drejtorët e komunës nuk janë prezentë të mbeten në ekstraktin e procesverbalit. Unë në Drejtorinë e Administratës, i kam bërë shtatë pyetje për qasje në dokumente zyrtare, sepse tani personi që mirret me këtë punë është Drejtori i Administratës, duke dashur këtu që të mos e dëmtoi buxhetin e komunës me shumën e mjeteve financiare prej: 28,000.00€, unë nuk

i dërgoi në Agjensi për Privatësi dhe Informim, sepse mjetet financiare që humben si gjoba janë mjete financiare të taksapaguesve tonë, por kërkoi që këto përgjigje të më kthehen me e-mail zyrtar, andaj as nuk e lëshoi mbledhjen e Kuvendit të Komunës, kur unë mendoj se ajo punë nuk është e arsyeshme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Grupi Punues e ka hartuar 'Planin e Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024' dhe ne duhet ta aprovojmë në parim për diskutim publikë. Unë kam tentuar që ta ndryshoi këtë formë të qasjes disa herë, kam kërkuar mirëkuptimin e juaj si të pozitës dhe opozitës, për të mos e përdorur arrogancën e numrave nga pozita, unë nuk pajtohem asnjëherë me reagimet e shpejta, nuk dua që këtu të matemi me gjoks, por me idenë e arsyeshmërisë.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim në parim për procedurën e diskutimit publik të 'Projekt-Planin e Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024'. U votua me: katërmëdhjetë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe një abstenim, gjithsej pesëmbëdhjetë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje, e aprovoi në parim për procedurën e 'Projekt-Planin Lokal të Veprimit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje për vitet 2024-2026'.

V E N D I M

1. Për aprovimin në parim për diskutim publikë të Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2024.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Planit Vjetor i Punës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2024.

Pika e pestë (5) - Shqyrtimi i dytë i Projekt-Planit Lokal të Veprimit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje për vitet 2024-2026.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani e kemi në shqyrtimin e dytë të 'Projekt-Planin Lokal të Veprimit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje për vitet 2024-2026'. Hap diskutimin.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për miratim 'Projekt-Planin Lokal të Veprimit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje për vitet 2024-2026'.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej gjashtëmbëdhjetë anëtarë të pranishëm në mbledhje. Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje, e miraton 'Projekt-Planin Lokal të Veprimit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje për vitet 2024-2026' dhe mori:

V E N D I M

1. Për miratimin e Projekt-Planit Lokal të Veprimit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje për vitet 2024-2026 në Komunën e Fushë-Kosovës.
2. Planit Lokal të Veprimit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje për vitet 2024-2026 në Komunën e Fushë-Kosovës, e cekur në pikën një të këtij vendimi, parasheh zbatimin nga institucionet komunale të programeve, punëve dhe aktiviteteve për mbrojtjen nga dhuna në familje.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Planit Lokal të Veprimit për mbrojtjen nga Dhuna në Familje për vitet 2024-2026 në Komunën e Fushë-Kosovës.

Pika e gjashtë (6) - Shqyrtimi i dytë i Projekt-Rregullores Komunale për Transparencë në Komunën e Fushë-Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani e kemi për shqyrtimin e dytë 'projekt-Rregulloren Komunale për Transparencë', e kemi përgatitur në Prevallë, prej neve Ekzekutivi i Komunës ka kërkuar që rregulloret tjera, të shqyrtohen në një periudhë të arsyeshme kohore në afatin kohorë të caktuar për periudhën e ardhshme.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për miratim 'Projekt-Rregulloren Komunale për Transparencë në Komunën e Fushë-Kosovës'.

U votua me: pesëmbëdhjetë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej gjashtëmbëdhjetë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje, e miraton 'Projekt-rregulloren Komunale për Transparencë në Komunën e Fushë-Kosovës' dhe mori:

V E N D I M

1. Për miratimin e Projekt-Rregullores për Transparencë në Komunën e Fushë-Kosovës.
2. Projekt-Rregullorja për Transparencë në Komunën e Fushë-Kosovës, e cekur në pikën një të këtij vendimi, parasheh rregullimin e transparencës në Komunën e Fushë-Kosovës.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Projekt-Rregullorja për Transparencë në Komunën e Fushë-Kosovës.

Pika e shtatë (7) - Shqyrtimi i Marrëveshjes për Bashkëpunim me Komunitet e Regjionit të Prishtinës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani unë dua të ju rikujtoj se ne në Kuvendin e Komunës e kemi miratuar iniciativën për arritjen e kësaj 'Marrëveshje të Bashkëpunimit me Komunitet e regjionit të Prishtinës'. Hap diskutimin.

Hasan Ismajli: Qëndrimin tim lidhur me këtë marrëveshje të bashkëpunimit, unë e kam thënë dje edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, në aspektin e qytetarët, sepse nuk jam aty anëtarë, unë me përgjegjëshmëri e kam lexuar këtë marrëveshje, andaj dua ta paraqes reagimin tim për linjat e transportit, e njoh këtë fushë sepse kam punuar në statcionin e autobusëve, ju po e shihni si janë përcaktuar linjat e autobusëve për qytetarët e Komunës së Prishtinës, në territorin e Komunës së Graçanicës për fshatin Mramor dhe me Komunën e Lipjanit për 'Prishtina Mall' dhe për Janjevë, ne kërkojmë që njësoi të hyn për ne edhe relacionet Prishtinë - Parku i Pishave Sllatinë e Vogël, Graboc i Poshtëm dhe Prishtinë, Harilaç, në drejtim të kalasë së Harilaçit, andaj unë këtu edhe përkundër se në disa fusha tjera kemi çështje të mira për qytetarët e komunës tonë, do të abstenoi me vetëdije.

Drejtori për Planifikim Urban: Përsëritës të pranishmit në mbledhje. Unë jam i autorizuar prej Nënkrjetarit të Komunës, për paraqitjen e kësaj 'Propozim-marrëveshje për bashkëpunim me Komunitet e Regjionit të Prishtinës' për shqyrtim, para se të hy në diskutim anëtarit të ri të Kuvendit të Komunës i dëshiroi punë të mbarë dhe suksese. Po ashtu nuk është në rregull që të bëhen pyetje me komente për punën e caktuar, pa e marrë përgjigjen e Ekzekutivit të Komunës. Unë i kam lexuar me kujdes të gjitha fushat, pajtohem me vërejtjet që mund të bëhen, por duhet të kemi parasysh se kjo marrëveshje i ka disa të mira që nuk kemi mundur t'i realizojmë në të kaluarën. Ne kemi probleme të theksuara me linjat e autobusëve, edhe për fshatin Miradi e Epërme, por kemi informata se për secilën fushë do të formohen grupet punuese, për hartimin e marrëveshjeve të veçanta.

Hasan Ismajli: Unë nuk dua ta bëjë këtu personin që bënë zhurmuesin, sepse do të largohesha nga mbledhja me kolegët nga opozita, nëse ne mund të bëjmë ndryshime në fushën e transportit unë jam që të votohet kjo marrëveshje.

Artan Asllani: Unë jam që të kalon kjo marrëveshje e bashkëpunimit, sepse i ka shumë favore për komunën e Fushë-Kosovës.

Laureat Gojnovci: Pas sqarimeve dhe konsultimeve tona dhe nevojës për shqyrtimin e fushës së transportit, edhe pse kjo marrëveshje ka shumë të mira për komunën tonë në fusha tjera, ne jemi që kjo 'Marrëveshje e Bashkëpunimit me Komunitat e Regjionit të Prishtinës' të shtyhet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen e radhës së Kuvendit të Komunës.

Pika e tetë (8) - Shqyrtimi i kërkesës për ndërrimin e anëtarit të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani e kemi për shqyrtim 'kërkesën e Grupit parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës për ndërrimin e anëtarit të saj në kuadër të Komitetit për Politikë dhe Financa'. Hap diskutimin.

Hasan Ismajli: Tani kolegët e mi nga subjektet tjera politike e lëshuan mbledhjen, andaj nuk kanë mundësi të japin qëndrimet e tyre, për çështjet ligjore të definuara në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës dhe Udhëzimit Administrativ për përbërjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, në udhëzimin administrativ të vitit 2019 dhe në ligj nuk shkruan askund që Lidhja Demokratike e Kosovës duhet të ketë tre anëtar, madje në udhëzim administrativ thotë se në komunitat ku janë tridhjetë e pesë mijë banorë, ky komitet duhet të ketë shtatë anëtar nga përbërja e entiteteve politike, ku në përbërjen e tij do të ishim edhe ne Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dhe Nisma Socialdemokrate, unë këtë sqarim e kërkoj, por këtu ka një heshtje, për të ruajtur secili pozitën e vetë. Në komunën tonë Komiteti për Komunitete i ka nëntë anëtarë, në kundërshtim me udhëzimin administrativ, ku katër anëtarë të tij janë nga subjektet politike shqiptare: Shpend Bardiqi, Dardane Sogojeva Shala, ju Jetmir Berisha dhe Arjeta Jashari, si dhe përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë, andaj ne e kërkojmë një sqarim në këtë rast edhe nga zyra ligjore, sepse këtë lëndë ne do të mundohemi ta dërgojmë për interpretim edhe në Gjykatën Kushtetuese, sepse në këtë rast është bërë shkelje e dispozitave ligjore.

Artan Asllani: Mënyrë e formimit të Komitetit për Komunitete, ne e dimë sikur është caktuar në fillim të mandatit tonë zgjedhor, aty janë përfshirë të gjitha komunitetet, ku znj. Linda Hyseni atëherë është propozuar nga znj. Qëndresa Ademi si përfaqësuese e komunitetit egjiptian, por ne tani e kemi një problem tjetër tani, sepse nuk e kemi mundësinë që të bëjmë pagesën e katër anëtarëve të tij, pas hyrjes në fuqi të ligjit të pagave, jemi duke punuar në Qeverinë e Kosovës për rregullimin e kësaj çështje.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Lidhur me pagesën e anëtarëve të Komitetit për Komunitete, vetë duhet të keni një iniciativë të përbashkët, me kërkesën që të rimbursohen pagesat për anëtarët e këtij komiteti të përhershëm.

Qëndresa Ademi: Po unë në fillim e kam propozuar znj. Linda Hyseni, sepse ne atëherë kemi qenë bashkë, nuk i kam pasur atëherë të njohura procedurat e themelimit të këtij komiteti.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim 'Propozimin për zëvendësimin e anëtarit të deritashën të Komitetit për Politikë dhe Financa z. Remzi Shala me z. Laureat Gojnovci'.

U votua me: katërmëdhjetë vota 'për', një votë 'kundër' dhe një abstenim, gjithsej gjashtëmbëdhjetë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave e aprovoi 'Propozimin për zëvendësimin e anëtarit të deritashëm të Komitetit për Politikë dhe Financa z. Remzi Shala me z. Laureat Gojnovci' dhe mori:

V E N D I M

1. Për ndryshim - plotësimin e paragrafit 1, nën-paragrafit 1.2, të vendimit Nr. 199, të datës 31.12.2021, për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa për të realizuar ndërrimin e përfaqësuesit të Lidhjes Demokratike të Kosovës, duke e larguar e z. Remzi Shala nga përbërja e Komitetit për Politikë dhe Financa prej shtatë anëtarëve dhe për caktimin e z. Laureat Gojnovci në cilësinë e anëtarit të ri të Komitetit për Politikë dhe Financa.
2. Ky vendim është pjesë përbërëse e vendimit Nr. 199, të datës 31.12.2021, për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, në Komunën e Fushë-Kosovës dhe parasheh detyrat dhe përgjegjësitë si: shqyrtimin e politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave, duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik, kornizën vjetore afatmesme buxhetore, planin vjetor të prokurimit, rregulloren vjetore për tatimet, tarifatat dhe pagesat, planin vjetor të punës për auditimin e brendshëm, buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim gjatë vitit fiskal, si dhe marrjen e raportit nga Kryetari i Komunës dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvendin e Komunës.

Pika e nëntë (9) - Shqyrtimi i kërkesës për ndërrimin e anëtarit të Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim 'Propozimin për zëvendësimin e z. Laureat Gojnovci me z. Fidan Berisha në përbërjen e re të Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale'.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej gjashtëmbëdhjetë anëtarë të pranishëm në mbledhje. Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave e aprovoi 'Propozimin për zëvendësimin e z. Laureat Gojnovci me z. Fidan Berisha në përbërjen e re të Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale' dhe mori:

V E N D I M

1. Për ndryshim - plotësimin e paragrafit 1, nën-paragrafit 1.1, të vendimit Nr. 52, të datës 07.03.2022 për themelimin e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për të realizuar ndërrimin e përfaqësuesit të Lidhjes Demokratike të Kosovës, duke e larguar z. Laureat Gojnovci nga përbërja e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale prej pesë anëtarëve dhe caktimin e z. Fidan Berisha në cilësinë e anëtarit të ri të Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
2. Ky vendim është pjesë përbërëse e vendimit Nr. 52, të datës 07.03.2022, për themelimin e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, në Komunën e Fushë-Kosovës dhe parasheh detyrat dhe përgjegjësitë e definuara në nenin 8, të Rregullores Nr. 04, të datës 12.01.2017, për përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve tjera.


Pika e dhjetë (10) - Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani e kemi pikën 'Të ndryshme', ju ftoi të paraqitni për shqyrtim ndonjë çështje nëse keni.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje në mbledhje. Mbledhja përfundoi në ora 12:40 minuta.

Procesmbajtës

Hasan Gjyrevci



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili

